Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/606
Datë: 13.10.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet dhe validohet** Institucioni Shkolla e Mesme e Mjekësisë "IMPERIUM" me adresë: Bernicë e Epërme-Prishtinë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2024 deri 31.08.2027, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 Teknik Dentar, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar të Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit 1 (një) klasë brenda vitit, me njëzetë (20) nxënës në klasë/grup si dhe dy (2) grupe për praktikë me nga dhjetë(10) veta në grup maksimumi.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Shkolla e Mesme e Mjekësisë "IMPERIUM" ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim për kualifikimin Teknik Dentar. AKK bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve të përcaktuara nga AKK sipas legjislacionit në fuqi.
Pas realizimit të vizitës nga ekipi i ekspertëve në këtë institucion dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipi i ekspertëve në raportin përfundimtar të hartuar me datë 07.09.2023 ka dhënë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitën e ekipit të ekspertëve në Shkollën e Mesme të Lartë të Mjekësisë "IMPERIUM" B.I. si dhe dokumente tjera shtesë.

Andaj, në bazë të kërkesës së Shkollës së Mesme të Mjekësisë "IMPERIUM" për akreditim dhe validim si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në Raportin e vlerësimit për institucionin aplikues, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Shkollës së Mesme të Mjeksisë "IMPERIUM"
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar i KD të AKK-së